REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 875/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.875/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Eurovia" Shpk – Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "NIKA PRO- ing sh.p.k & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori" Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponit Sanitare dhe ST të KMDK-së", me nr. të prokurimit KMDK-20-985-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosovë/KMDK/, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Eurovia" Shpk – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponit Sanitare dhe ST të KMDK-së", me nr. të prokurimit: KMDK-20-985-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosovë/KMDK/.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponit Sanitare dhe ST të KMDK-së", me nr. të prokurimit: KMDK-20-985-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosovë/KMDK/, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Eurovia" Shpk – Prizren, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Eurovia" Shpk – Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 875/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponit Sanitare dhe ST të KMDK-së", me nr. të prokurimit: KMDK-20-985-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kompania për Menaxhimin e Deponive ne Kosovë/KMDK/, duke pretenduar:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56, 59, 61, 68, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 10.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit:

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "EUROVIA" SHPK, pretendon se AK, nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE ashtu siç parashihet në nenin 7 të LPP-së, sepse pajisjet për të cilat jemi eliminuar ne si OE, për mungesë të dëshmive nuk qëndron. Sepse këto pajisje janë të blera në ankand publik dhe janë pa DUDA Doganor, mirëpo për faktin se janë në pronësi, kontrata është e noterizuar, si dhe është pjesë e kontratës të cilën u a prezantojmë.

Duke pas parasysh kërkesën e Dosje të Tenderit dhe në njoftimit për kontratë, ku thuhet që *"Për kryerjen e shërbimeve OE duhet të dëshmojnë se i kanë në pronësi makinerinë"*, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE "EUROVIA" SHPK, që nuk është respektuar neni 7 i LPP-së, nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE, për faktin se pajisjet që janë ofruar me kontratën e shitblerjes në mes të

anëtarit të konsorciumit "BEJTA COMMERCE SH.A" dhe AKM-së. Dallimi është se pajisjet të cilat i ka paraqitur OE ankues i ka marrë në shfrytëzim për projektin në fjalë nga OE "BEJTA COMMERCE SH.A", kurse në këtë projekt "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", janë anëtar të konsorciumit, dhe pajisjet në fjalë janë në pronësi të anëtarit të konsorciumit, pra nga konsorciumi është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë, për më tepër shihe dëshmitë, Vendimin e PSH. Të datës 09.10.2020 me nr. 623-635/20.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Nika Pro-Ing" SH.P.K & "Bejta Commerce" SH.A & "Eskavatori" - Ferizaj, se OE i rekomanduar per kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional, Neni 9.1 dhe 9.2 i FDT-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Për kryerjen e shërbimeve OE duhet të dëshmoj se i ka në pronësi Ekskavator me kapacitet 5 deri 10 ton min 2. Ekskavator me kapacitet 15 deri 25 ton min 4. Ekskavator me kapacitet mbi 30 ton min 1. Ekskavator me kapacitet mbi 40 ton min 1. Ekskavator me kapacitet mbi 50 ton min 1. Ngjeshës-Cilindër mbi 5 ton min 1. Ngjeshës- Cilindër mbi 12 ton min 1. Ngjeshës-Cilindër mbi 24 ton min . Bulldozher me kapacitet 15 deri 25 ton min 3. Rrafshues grejder min 1. Kamion special apo auto kran për tërheqjen e makinerisë gjatë defekteve-min 10 ton". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Kopjet e librezave apo DUD Doganor".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, i njëjti ka paraqitur një listë të makinerisë në pronësi të tij e cila nuk e plotëson tërësisht kërkesën e FDT-së dhe me këtë rast i rekomanduari për kontratë ka lidhur një marrëveshje me kompaninë Bejta Commerce SH.A për shfrytëzim të makinerisë deri në përfundim të projektit në fjalë, bëhet fjalë për dy makineri: Një Cilindër pesha e të cilit është 24.598 KG dhe Një Ekskavator pesha e të cilit është 79.800 KG. Duke pas parasysh se në Dosje të Tenderit dhe në njoftimit për kontratë thuhet decidivisht që për kryerjen e shërbimeve OE duhet te dëshmojnë se i kanë në pronësi makinerinë, të kërkuar tek kapacitetet teknik dhe profesional, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i grupit të operatorëve ekonomik ankues është i bazuar për faktin se dëshmitë nuk janë konform dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit tjetër të grupit të operatorëve ekonomik ankues "Nika Pro-Ing" SH.P.K & "Bejta Commerce" SH.A & "Eskavatori" - Ferizaj, se OE i rekomanduar për kontratë ka lidhur marrëveshje me OE NTSH "SEDTOURS" & Daut Gashi B.I, për shfrytëzimin e pajisjeve. Për këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka marrëveshje për shfrytëzim të pajisjeve, bëhet fjalë për 8 (Tetë) pajisje gjithsej. Në dosjen e tenderit dhe në njoftimit për kontratë është kërkuar: "Për kryerjen e shërbimeve OE duhet te dëshmoj se i ka në pronësi Ekskavator me kapacitet 5 deri 10 ton min 2. Ekskavator me kapacitet 15 deri 25 ton min 4. Ekskavator me kapacitet mbi 30 ton min 1. Ekskavator me kapacitet mbi 40 ton min 1. Ekskavator me kapacitet mbi 50 ton min 1. Ngjeshës-Cilindër mbi 5 ton min 1. Ngjeshës- Cilindër mbi 12 ton min 1. Ngjeshës-Cilindër mbi 24 ton min. Bulldozher me kapacitet 15 deri 25 ton min 3. Rrafshues grejder min 1".

Andaj, OE i rekomanduari për kontratë për disa pajisje ka lidhur marrëveshje për shfrytëzim të tyre. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që kjo marrëveshje nuk është konform dosjes së tenderi dhe

pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar për faktin se një marrëveshje e tillë nuk është e lejuar në FDT.

Kjo është lista e pajisjeve të ofruara nga konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", me të gjitha pajisjet e kërkuara në DT dhe në njoftimin për kontratë.

Kerkesat per makineri-Permbajtja e dokumentacionit				
Pershkrimi i pajisjes	Viti	Pesha	Pronesia	Dokumentacioni
Eskavator me kapacitet 5 deri 10 ton min 2				
1. CASE BAGERLADER, TIPI: 695 SR	2000	9500	Eskavatori	DUD Doganor
2. NAKLADALEC, TIPI: 432D	2005	8620	Eskavatori	DUD Doganor
Eskavator me kapacitet 15 deri 25 ton min 4				
1. CASE BAGERLADER, TIPI: WX 145	2009	16312	Eskavatori	DUD Doganor
2. MOBILBAGER LIEBHERR, TIPI: A 902	1996	17000	Eskavatori	DUD Doganor
3. RADLADER O&K, TIPI: I 45	1996	19500	Eskavatori	DUD Doganor
4.VOLVO, TIPI: EC 210 BLC	2004	22000	Eskavatori	DUD Doganor
Eskavator me kapacitet mbi 30 ton min 1				
1. HITACHI, TIPI: ZX 350	2005	33800	Eskavatori	DUD Doganor
Eskavator me kapacitet mbi 40 ton min 1				
1. CASE, TIPI:CX 470B	2009	47400	Eskavatori	DUD Doganor
Eskavator me kapacitet mbi 50 ton min 1				
1. ESKAVATOR ELK, TIPI: UNEX E303	1985	79800	Bejta commerce	AKP Kontrate
Ngjeshes-Cilinder mbi 5 ton min 1				
1. BOMAG, TIPI: BW212 D-3	2000	11000	Eskavatori	DUD Doganor
Ngjeshes-Cilinder mbi 12 ton min 1				
1. COMAC, TIPI: BOXER 119	2005	19500	Eskavatori	DUD Doganor
Ngjeshes-Cilinder mbi 24 ton min 1				
1. BOMAG, TIPI: BW 20R	1989	24598	Bejta commerce	AKP Kontrate
Bulldozher me kapacitet 15 deri 25 ton min 3				
1. CATERPILAR, TIPI: D6T LGP	2009	25000	Eskavatori	DUD Doganor
2. CATERPILAR, TIPI: D6H	1989	20000	Eskavatori	DUD Doganor
3. CATERPILAR, TIPI: D5H	1993	16200	Bejta commerce	DUD Doganor
Rrafshues grejder min 1				
1. BOMAG, TIPI: BG 160 T	2000	13980	Eskavatori	DUD Doganor
Kamion special apo auto kran per terheqjen e makinerise gjate defekteve-min 10 ton				
1. CONTINENTAL, TIPI: CCA.10 350 CCM 12 667	1975	44540	Bejta commerce	DUD Doganor

Nika Pro-Ing sh.p.k.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar: *"Për kryerjen e shërbimeve OE duhet të dëshmoj se i ka në pronësi, Eskavator me kapacitet 5 deri 10 ton min 2, Eskavator me kapacitet 15 deri 25 ton min 4, Eskavator me kapacitet mbi 30 ton min 1, Eskavator me*

kapacitet mbi 40 ton min 1, Eskavator me kapacitet mbi 50 ton min 1, Ngjeshes-Cilinder mbi 5 ton min 1, NgjeshesCilinder mbi 12 ton min 1, Ngjeshes-Cilinder mbi 24 ton min 1, Bulldozher me kapacitet 15 deri 25 ton min 3, Rrafshues grejder min 1 dhe Kamion special apo autokran për tërheqjen e makinerisë gjatë defekteve min 10 tonë".

Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, pajisjet Eskavator me kapacitet 5-10 ton- min 2, sepse njëri është Skip dhe tjetri Nakladalec tip 432D.

Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", në dosjen e tenderit i ka ofruar DUDAT Doganor, me përshkrimin dhe peshën për dy eskavator, me peshën ashtu siç janë kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, mirëpo për ta sqaruar sa më mirë këtë çështje, AK konfom pragrafit 2 të nenit 59 dhe nenit 72 të kërkoj sqarime shtesë.





Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku i ka ofruar tre ekskavator me kapacitet 15-25 ton, ndërsa njëri është ngarkues i cili është i prezantuar në listen e pajisjeve me emërtimin Radiader O&K tipi L45, e për të cilin kërkon të verifikohet.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", i ka ofruar Eskavatorët me peshat e kërkuara 15-25 ton min 4, shihë dëshmitë, mirëpo për ta sqaruar sa më mirë këtë çështje, AK konfom paragrafit 2 të nenit 59 dhe nenit 72 të kërkoj sqarime shtesë.


3/8
PËR EXP/IMP
FOR EXP/IMP
ZA IZVOZ/UVZ

KOPJA PËR VËRTETIMIN E PRANIMIT

KOPJA PËR ZYRËN DOGANORE DESTINUESE

DOKUMENTI UNIK DOGANOR

3 8

GRRL BAUMASCHINEN HANDEL
GES M.B.H.AUSTRIA/AT

IM 4

3012 DD PEJE
9797/08/06/04

"ESKAVTORI" 006366

FERIZAJ 80012352

"B A I" PEJE 001178

AUSTRIA

AT

AT/AUSTRIA

871 Z 326/823 R 762 BA 0

EXW HAID

EUR 26000,00

30

3011

3 8

I/00.5

EKSKAVATOR I RËRËPUNUES,
PËRMBAJTËS DEKLARATË SIPËR LIRËSIMIT
ARTIKEL Nr.100302
VITI I PRODHIMIT:1996. Nr.SERIK:356340
FUQIA:17 kW. e 1 [illegible]

84295900 00

17000,00 100

1000 01 17000,00

DE-04-3012/7102-01

1/CP 26000,00 1

(FOI) (TO6) (V31) (C01)
A20041211,1150294, 1500, 0028365

"ESKAVTORI" FERIZAJ 006366/80012352

CO	27500,00	10	2750,00	
VT		15	4538,00	
		EUR=	7288,00	

08.06.2004

PEJE MË 08.06.2004

00377 116741

DOKUMENTI UNIK DOGANOR

3 8

KOPJA PËR VËRTETIMIN E PRANIMIT

KOPJA PËR ZYRËN DOGANORE DESTINUESE

1. NDËRTIMORI

2. ZYRA DOGANORE NËNGRESE (EKSPORTIMORE) NËNTRETE

2012/11 2

2. EMËRTIMI 4. KATEGORIA 5034/0 0 4

9. EMËRTIMI DHE ADRESA E EKSPORTUESIT

"ZENITA TOUR" 20037671

PRIFTI VASOSH P.QESAR

006386

10. EMËRTIMI DHE ADRESA E PRANUESIT

"A A I" 001178

PRIFTI

14. DEKLARUESI DHE ADRESA

001178

15. ZYRA NËNGRESE

BAJRAM CURRI

16. VENDI I DEKLARIMIT

DOGANA PRIFTI

17. VENDI I DESTINACIONIT

18. IDENTITETI KOMBËTAR I MJETIT TRANSPORTUES NË FLUJIN KUFIRIT

229 J 837/210 M 003

19. KOD

IA 0

20. KUSHTET E NËNGRESËS

EXW STADIUMI

21. IDENTITETI KOMBËTAR I MJETIT TRANSPORTUES I DALË I FLUJIT KUFIRIT

22. MONEDHA DHE SHUMA E PËRGJITHSHME NDËR FATURËN

EUR 37000,00

23. KURSI I VALUTËS

24. LLOJI PËRFITIMIT TË ARKËT. TË TRANSITIMIT DHE JASHTË

25. LLOJI I NDËR TË NDËR

30

26. LLOJI I KONTEJNERËVE TË ZBRAZËTË

27. NUMËR I KONTEJNERËVE

28. TË DHËNAT FINANCIARE DHE BANKARE

29. ZYRA DOGANORE KALIMI/DËRGIMI

7011

30. VENDI I NGARKIMIT

31. PËRMBYLLJA DHE NUMËRI - NR. SERIOR/LLOJI - NUMËRI DHE LLOJI

1/0012

SHKAVARRI/TSAATON 1.VTIAVZ NG LMETA, I TZOOBURZ,RA/RA:HAPLADER OBK. ZIPI:DA5.MUZRA SMOOK, KK.I OMKLIRE:165040.VIPI I ZHOMAKITO: 1906.

32. NUMËRI I ARTIKULIT

1

33. KODI I MALLIT

97013005 00

34. KODI I VENDIT TË DËRGUARËS

35. MASA BRUTO NË KG.

19500,

36. REGJIMI

300

37. PROCEDURA

8000 01

38. MASA NETO NË KG.

37500,00

39. KUOTA

40. DOKUMENTI PARAPRAK

40-3012/2412-01

41. NJËSIA SASIORE

1/OT.

42. ÇMIMI I MALLIT

37000,00

43. M.V.

1

44. DOKUMENTE DHE DOKUMENTE TË TJERË PËRFSHIRË

(201) (906) (731)

200440570 115417) 1500,00

SHKAVARRI Y.VASOSH PRIFTI

006386/20037671

45. LLOGARITJA E TAKSËVE

LLOJI	BAZA PËR LLOGARITJE	PËRQINDJA	SHUMA	M.P.
B0	38500,00	10		
V2		15	5775,00	
		KATEGORI	EUR	5775,00

46. PAGESA I NËRMJETME

47. IDENTIFIKIMI I DEPOSË

48. DETYRIMET E LLOGARITJES

49. IDENTITETI I MAGAZINËS

NËNKONTRATË NR.:

NDËRTIMORI

E. ZYRA DOGANORE E NISJES

51. ZYRA DOGANORE E TRANZITIT

52. GARANCIA E LIDHUR NGA PALË

53. ZYRA DOGANORE DESTINUESE

54. LI KONTROLLA E ZYRËS DOGANORE KUFIRE - DESTINUESIT

REGISTRATË

PLANIFIKIMI I DERGIMIT

IDENTITETI

DATË

NËNSHKRIMI

VULA

55. VENDI DHE DATA

TIRANË 10.12.2012

NËNSHKRIMI DHE EMËRI I DEKLARUESIT



Dokumenti Unik Doganor

ZYRA E DESTINIMIT 2060 ZBO FERIZAJ

DEKLARATE IM 4

RITCHIE BROS AUCTIONEERS -ZEVENBERGEN/NL

COMPANYA " ESKAVATORI " SH.P.K. MAGJIS FERIZAJ - PRISHTINË FERIZA

"PROSHPED" SH.P.K. RRUE QARKUT, FERIZAJ

HOLANDA

SUEDIA

KOSOVA

VR0692L 635KS187

EXW ZEVENBERGEN/NL

EUR 25.952.50

3041 PIKK DHEU I BARDHË

Makinerillë so ljera me mbyllim të kujendshkunës 360°

Eskavator i perdorur - Marka:VOLVO Tipi:EC210BLC (Hydraulic Excavator) Nr.Serik:EC210V30352 Viti 2004

4.335.00+0.00+0.00+35.00-0.00

0.bv 350.934

385360

Lloji	Bazës e taksës	Norma	Shuma	NP
CD	30.332.500	0.000	0.00	1
VT	30.332.500	18.000	5.459.85	1
		Totali	5.459.85	T

DETAJET E LIQIMIT

Mënyra e pagesës KESH

Numri i Pranimit L 13994 Data 27/06/2018

Numri Pagesës P 9334 Data 27/06/2018

Garancioni 0.00 EUR

Totali shtesëmbanës 0.00 EUR

Totali liqiduar 5.459.85 EUR

ORITON BYTYQI

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku kamion Vinç i ofruar nga i rekomanduari për kontratë nuk e ka mekanizmin për tërheqje të makinerive të cilat janë në defekte.

Eksperti shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar: ***"Kamion special apo autokran për tërheqjen e makinërisë gjatë defekteve min 10 tonë"***, *pra përveç Kamionit special, për të cilin pretendon OE ankues , është përdorur fjala* ***APO*** *autokran për tërheqjen e makinërisë gjatë defekteve min 10 tonë.*

Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", në dosjen e tenderit e ka ofruar DUD-in doganor dhe Librezën e qarkullimit, të cilat dëshmi mund ti shihni më poshtë, mirëpo për ta sqaruar sa më mirë këtë çështje, AK konfom paragrafit 2 të nenit 59 dhe nenit 72 të kërkoj sqarime shtesë.


DOKUMENTI UNIK DOGANOR

TRUCK IMPEX
6020 INNSBRUCK/AT

IM 4
1 1
01 01
VERMICA-TERMINALI
11204200001710O 28/06/2011
CS-0353
DO-VERMICE-2042

70552477
N.N.T. ..CRAI"
RAMUNE HAXHI ZEKA NR.12, PEJË

70552477
N.N.T. ..CRAI"
RAMUNE HAXHI ZEKA NR.12, PEJË

80000812
N.T.SH. ..IDEAL COOP"
TE TERMINALI DOGANOR, PEJË

AUSTRIA
AT
SLOVENIA

IIBZD AT 0
EXW INSBRUCK

EUR 7000.00
1
30
2041

01 COPE
AUTOVINÇ I PËRDORUR,
MARKA CONTINENTAL, TIPI C.C.A 10.350, CCM:12667,
KW:169, QYER:2, ULESE:2, NGJYRA VERDHE/KALTERT,
VITI I PRODHIMIT/REGJ 1975,
NR SHASIE29273
NR SERIK-7504012/35

1 87051000 00
SI 44540.00 220
40.00 1 0 44540.00
EP 11 2042 112041001651 1/1-1 1
1.00 PCE 7000.00 6
LB
0.00

V31/500.00 €
FO1/133,TOB/SH/SI%6571259,
US,MJET/F0671827,T99/

VT	23.970.00	16.00	3.835.20
		SUMA	3.835.20

0.00

Faqe **11** nga **18**



Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

Operatori ekonomik ankues pretendon që AK nuk e ka trajtuar të barabartë me OE të rekomanduar për kontratë ku thotë se OE i rekomanduar për kontratë i mungojnë DUD Doganor për dy pajisje (Liebherr R 924 dhe për pajisjen Unex E303 të marr me qera nga kompania Bejta Commerce). Gjithashtu kërkojmë që të respektohet vendimi i i OSHP-se me nr. 623/20 dhe 635/20 sepse me vendimin e OSHP-së, është vlerësuar si i bazuar pretendimi i OE "Joos Krasniqi", lidhur me kërkesën ku sipas vendimit neve na ka munguar dëshmia sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Pas analizimit te dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit për Eskavator Liebherr R924 është prezantuar një fotografi dhe një Faturë mirëpo mungon dëshmia DUD Doganor, si dhe sa i përket pretendimit për makinerinë tjetër Unex E303, po ashtu edhe për këtë pajisje mungon dëshmia DUD Doganor, është i qëndrueshëm pretendimi në fjalë në lidhje me DUDAT Doganor. Në vendimin e Panelit shqyrtues të datës 09.10.2020 është vlerësuar si i bazuar pretendimi i OE ankues " JOOS KRASNIQI" Në vijim po u bashkëngjisim pjesë nga vendimi i Panelit Shqyrtues për ankesën 623/20 dhe 635/20

Për pretendimin e OE ankues "JOOS & KRASNIQI-BAZE SH.P.K.; G-PROJECT SH.P.K." se AK nuk i ka trajtuar të barabartë me OE të rekomanduar për kontratë, ku thotë se OE i rekomanduar për kontratë i mungojnë DUD Doganor për dy pajisje (Liebherr R 924 dhe për pajisjen Unex E303 të marr me qira nga kompania Bejta Commerce). Pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit për Ekskavator Liebherr R924 është prezantuar një fotografi dhe një Faturë mirëpo mungon dëshmia DUD Doganor, ndërsa sa i përket pretendimit për makinerinë tjetër Unex E303, po ashtu edhe për këtë pajisje mungon dëshmia DUD Doganor, andaj ky pretendim i OE ankues qëndron i bazuar për faktin se dëshmia nuk është konform dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "EUROVIA" SHPK, të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konfirmojmë pranimin e shkresës dhe njëkohësisht ju informojmë se nuk pajtohemi me ekspertin për ri-vlerësim me arsyetimin ne vijim:

Edhe vet eksperti ne mendim e paska cekur qe OE i rekomanduar për kontrate i plotëson kriteret, por vetëm për sqarime shtese e thotë te kthehet ne ri-vlerësim.

Nëse OE i plotëson kriteret nuk është e domosdoshme për sqarime shtese.

Gjithashtu edhe njeher ju lutemi panelit shqyrtues për përshpejtim te lendes.

Duke marre parasysh qe kemi pengesa ne zhvillimin e aktiviteteve operative, kërkojmë qe kjo lende te shqyrtohet sa me shpejt qe është e mundur.

Shprehim shqetësimet tona si Ndërmarrje Publike për shkak te natyrës specifike te punës nga mostrajtimi i mbeturinave mund te vij deri te pasojat e mëdha ekologjike dhe përhapjen e epidemive sidomos tani qe është përhapur COVID-19.

Tani jemi ne situate tejet te rende dhe emergjente ku edhe munde te mbyllen deponite sanitare te mbeturinave.

Ju lutem ta merrni ne konsideratë trajtimin e kësaj lende sepse jemi duke u ballafaquar me probleme te mëdha operative ku ndikon drejtpërdrejt ne funksionimin e kompanisë.

Gjithashtu gjeni te bashkangjitur ne attach vërejtjen nga KRM PASTRIMI për ankesat qe kane lidhur me infrastrukturën rrugore ne Deponi për shkake te rrugëve te pakalueshme.

Shpresojmë qe kërkesa jone te hase ne mirëkuptimin tuaj!

Për: KDMK-në - Prishtinë

Nga: KRM "Pastrimi"-Sh. A-Prishtinë, Rr Tahir Zajmi nr 5

Lënda: Njoftim & Kërkesë.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se, kushtet për operimin dhe zbrazjen e kamionëve të KRM "Pastrimi"-Prishtinë, në Deponinë sanitare në Mirash janë në nivelin shumë të dobët dhe si pasojë e kushteve të tilla kamionët tonë po dëmtohen dhe po shkatrrohen për çdo ditë pune.

Vërejtje për kushtet e zbarazjes së kamionëve në Deponi, ka dhenë edhe Ekipa profesionale të cilen e ka angazhuar Kryeshefi për shiqim në vendin e ngjarjes .

Kjo gjendje është e papërballueshme sepse si pasojë e mungesës së trasesë për zbrazje dhe nga rruga me baltë ku kamionat tonë sharrojnë dhe bllokohen dhe prandaj dëmtohnen teknikisht, duke rritur koston enorme të shpenziemve, të cilën kompania jonë nuk po mund ta përballoj, e sidomos:

- dëmtimi i gomave,
- dëmtimi i lamellave,
- Ndrruesit të shpejtësive,
- Filterave të ajrit, dhe
- Makanizmit tj etër gj atë tërheqj es dhe shtyerj es për nxj errj en e kamionëve nga balta dhe nga gropat në Deponi.

Prandaj kërkojmë që me urgjencë, të rregullohet trasea dhe rruga hyrëse, për evitimin e baltës dhe të krijohen kushte për zbrazje të papenguar, në mënyrë që kamionët tonë mos të shkatrrohen, me ç'rast<^5he'"^fiengohet procesi i punës në bartjen e mbeturinave. Dt.27.10.2020

Operatori ekonomik me datë 10.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar , pasi pranuam raportin e ekspertizës me nr 875-20 ,vlerësimi ynë është se pajtohemi pjesërisht me vlerësimin e ekspertit shqyrtues. Sa i përket propozimit për Rivlerësim te aktivitetit Pajtohemi.

Ndërsa sa i përket vlerësimit lidhur me pajisjet e OE te rekomanduar për Kontrate NUK Pajtohemi sepse nuk ka qfar te sqarohet te pisja e Autokranit kur e njëjta shihet edhe ne foto se nuk ka te beje fare me pajisjen e kërkuar sepse ne kërkesën e DT është kërkuar : Kamion Special apo Autokran për tërheqjen e makinerisë gjate defekteve min 10T, dhe eksperti kërkon te sqarohet me nenin 72, ndërsa neve për pajisjen Liebherr 924 e cila është e tepërt na eliminon me automatizëm.

Eksperti nuk është marre fare me provat e ofruara nga ana jone si ato (linku - dhe fotot e bashkangjitura ne ankes)lidhur me pajisjet e OE te rekomanduar për kontrate.
Edhe sa i përket pajisjes Liebherr R924 ne ankesën tone kemi sqaruar se janë kërkuar 4 pajisje dhe paisja liebherr R924 është e tepërt ne ofertën tone dhe ketë fakt nuk e keni konstatuar si ekspert shqyrtues.

Ju lutemi qe te na konfirmoni pranimin e kësaj imelle.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.
Lidhur me pretendimin e OE ankues "EUROVIA" SHPK, se AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE ashtu siç parashihet në nenin 7 të LPP-së, sepse pajisjet për të cilat jemi eliminuar ne si OE, për mungesë të dëshmive nuk qëndron. Sepse këto pajisje janë të blera në ankand publik dhe janë pa DUDA Doganor, mirëpo për faktin se janë në pronësi, kontrata është e noterizuar, si dhe është pjesë e kontratës të cilën u a prezantojmë.
Paneli Shqyrtues duke pas parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimit për kontratë ku thuhet që "Për kryerjen e shërbimeve OE duhet të dëshmojnë se i kanë në pronësi makinerinë", sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE "EUROVIA" SHPK që nuk është respektuar neni 7 i LPP-së(Paneli shqyrtues nuk ka ndonjë dëshmi qe AK ka sqaruar se pajisjet te jene 60% ne pronësi nga lideri), për faktin se pajisjet që janë ofruar me kontratën e shitblerjes në mes të anëtarit të konsorciumit "BEJTA COMMERCE SH.A" dhe AKM-së. Dallimi është se pajisjet të cilat i ka paraqitur OE ankues i ka marrë në shfrytëzim për projektin në

fjalë nga OE "BEJTA COMMERCE SH.A", kurse në këtë projekt "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", janë anëtar të konsorciumit, dhe pajisjet në fjalë janë në pronësi të anëtarit të konsorciumit, pra nga konsorciumi është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë.
Kurse, sa i përket listës së pajisjeve të ofruara nga konsorciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", me të gjitha pajisjet e kërkuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, pajisjet Eskavator me kapacitet 5-10 ton- min 2, sepse njëri është Skip dhe tjetri Nakladalec tip 432D.
Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar: "Për kryerjen e shërbimeve OE duhet të dëshmoj se i ka në pronësi, Eskavator me kapacitet 5 deri 10 ton min 2, Eskavator me kapacitet 15 deri 25 ton min 4, Eskavator me kapacitet mbi 30 ton min 1, Eskavator me kapacitet mbi 40 ton min 1, Eskavator me kapacitet mbi 50 ton min 1, Ngjeshes-Cilinder mbi 5 ton min 1, NgjeshesCilinder mbi 12 ton min 1, Ngjeshes-Cilinder mbi 24 ton min 1, Bulldozher me kapacitet 15 deri 25 ton min 3, Rrafshues grejder min 1 dhe Kamion special apo autokran për tërheqjen e makinerisë gjatë defekteve min 10 tonë".
Paneli Shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", në dosjen e tenderit i ka ofruar DUDAT Doganor, me përshkrimin dhe peshën për dy eskavator, me peshën ashtu siç janë kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku i ka ofruar tre ekskavator me kapacitet 15-25 ton, ndërsa njëri është ngarkues i cili është i prezantuar në listën e pajisjeve me emërtimin Radiader O&K tipi L45, e për të cilin kërkon të verifikohet.
Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", i ka ofruar Eskavatorët me peshat e kërkuara 15-25 ton min 4, ku në shkresat e lëndës janë bashkangjitur DUD-at.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe

njoftimit për kontratë, ku kamion Vinç i ofruar nga i rekomanduari për kontratë nuk e ka mekanizmin për tërheqje të makinerive të cilat janë në defekte.

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar: ***"Kamion special apo autokran për tërheqjen e makinërisë gjatë defekteve min 10 tonë"***, *pra përveç Kamionit special, për të cilin pretendon OE ankues , është përdorur fjala* ***APO*** *autokran për tërheqjen e makinërisë gjatë defekteve min 10 tonë.*

Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës "NIKA PRO-ing SH.P.K & Bejta Commerce sh.a & Eskavatori", në dosjen e tenderit e ka ofruar DUD-in doganor dhe Librezën e qarkullimit, dëshmi të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK nuk e ka trajtuar të barabartë me OE të rekomanduar për kontratë, ku thotë se OE i rekomanduar për kontratë i mungojnë DUD Doganor për dy pajisje (Liebherr R 924 dhe për pajisjen Unex E303 të marr me qira nga kompania Bejta Commerce). Gjithashtu, kërkojmë që të respektohet vendimi i OSHP-se me nr. 623/20 dhe 635/20 sepse me vendimin e OSHP-së, është vlerësuar si i bazuar pretendimi i OE "Joos Krasniqi", lidhur me kërkesën ku sipas vendimit neve na ka munguar dëshmia sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit për Eskavator Liebherr R924 është prezantuar një fotografi dhe një Faturë mirëpo mungon dëshmia DUD Doganor, si dhe sa i përket pretendimit për makinerinë tjetër Unex E303, po ashtu edhe për këtë pajisje mungon dëshmia DUD Doganor, është i qëndrueshëm pretendimi në fjalë në lidhje me DUDAT Doganor. Pra Operatori i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotësuar këtë kërkesë te Autoritetit Kontraktues te publikuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit. Në vendimin e Panelit shqyrtues të datës 09.10.2020 është vlerësuar si i bazuar pretendimi i OE ankues " JOOS KRASNIQI"

> Për pretendimin e OE ankues "JOOS & KRASNIQI-BAZE SH.P.K.; G-PROJECT SH.P.K." se AK nuk i ka trajtuar të barabartë me OE të rekomanduar për kontratë, ku thotë se OE i rekomanduar për kontratë i mungojnë DUD Doganor për dy pajisje (Liebherr R 924 dhe për pajisjen Unex E303 të marr me qira nga kompania Bejta Commerce). Pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit për Ekskavator Liebherr R924 është prezantuar një fotografi dhe një Faturë mirëpo mungon dëshmia DUD Doganor, ndërsa sa i përket pretendimit për makinerinë tjetër Unex E303, po ashtu edhe për këtë pajisje mungon dëshmia DUD Doganor, andaj ky pretendim i OE ankues qëndron i bazuar për faktin se dëshmia nuk është konform dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform kërkesës së dosjes së tenderit. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform kërkesës së dosjes së tenderit lidhur me pajisjen ne fjalë dhe të bëjë

ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke i respektuar kërkesat e vendosura ne njoftimin per kontrate dhe te dosjes se tenderit si dhe sqarimet nëse ka patur para dorëzimit te tenderve.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.
Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KMDK;
1x1 OE "EUROVIA" SHPK-Prizren;
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.